



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, kuvendi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejme "Kuvendi i FAK") me datën 15.11.2018 miratoi këtë rregullore:

### **RREGULLORE 03/2018**

#### **RREGULLORE E PUNËS SË KUVENDIT**

##### **Neni 1**

##### **Mbledhja e Kuvendit**

1.1 Si organi më i lartë i FAK-ut, Kuvendi përbëhet nga delegatët e akredituar të emëruar nga Anëtarët Aktivë, Bordi Ekzekutiv i FAK-ut, Komisioni Mbikqyrës i FAK-ut, Kryetari i Nderit, nëse ka, dhe të ftuarit tjerë të akredituar të përcaktuar nga Bordi Ekzekutiv ose vëzhguesit siç përcaktohet me statut.

1.2 Kuvendi i FAK-ut mbledhet së paku një herë në vit në mbledhjen e rregullt.

1.3 Kuvendi mund të thirret për:

1.3.1 Mbledhje të Rregullt të Kuvendit

1.3.2 Mbledhje të Jashtëzakonshme të Kuvendit

1.3.3 Mbledhje Zgjedhore të Kuvendit

1.4 Puna e Kuvendit thirret dhe organizohet sipas kesaj rregulloreje, rregullore e cila përcaktohet dhe miratohet nga Kuvendi, dhe kjo rregullore ndryshohet vetëm me dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit me të drejtë vote.

1.5 Mbledhjet e Rregullta dhe të Jashtëzakonshme të Kuvendit thirren dhe organizohen nga Bordi Ekzekutiv i FAK-ut.

1.6 Mbledhjet e Jashtëzakonshme të Kuvendit mund të thirren dhe të organizohen me miratimin e pesëdhjetë përqind plus një votë (50% + 1 votë) të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të FAK-ut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj.

1.7 Mbledhja Zgjedhore e Kuvendit të FAK-ut do të thirret dhe organizohet nga Bordi Ekzekutiv i FAK me rastin e përfundimit të mandatit të Bordit Ekzekutiv dhe të Kryetarit.

1.8 Mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit mund të shndërrohet në mbledhje Zgjedhore të Kuvendit vetëm nëse dy të tretat (2/3) e delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë me të drejtë vote në Kuvend dhe të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit votojnë për një shndërrim të tillë. Në këtë rast për zgjedhjen e kryetarit duhet të respektohen plotësisht kriteret e caktuara në statut për kualifikimin për kandidat për kryetar të FAK.



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

### **Neni 2 Përbërja e Kuvendit**

2.1 Delegacioni zyrtar i Anëtarëve Aktivë në mbledhjen e Kuvendit përbëhet nga numri i delegatëve të akredituar dhe të garantuar për organizatën bazuar në klasën e anëtarësimit të organizatës, siç janë:

Anëtarësimi në klasën A - Katër (4) delegatë me të drejtë vote, me së paku një grua delegate që është gjë e cila është detyruese për delegacionin.

Anëtarësimi në klasën B - Dy (2) delegatë me të drejtë vote.

Anëtarësimi në klasën C - Një (1) delegat me të drejtë vote.

Anëtarësimi në klasën D - Një (1) delegat pa ASNJË drejtë vote.

Një nga delegatët do të shërbejë si Kryesues dhe zëdhënës i Delegacionit. Anëtarët e tjerë të delegacionit do të marrin lejen e atij individit para se të mund t'i drejtohen Kuvendit.

Një delegat që përfaqëson një organizatë Anëtare Aktive në mënyrë që të akreditohet duhet të abonohet në organizatë dhe FAK-u duhet të informohet për abonimin e tillë të paktën 90 ditë para datës në të cilën mbahet Mbledhja e Kuvendit.

2.2 Bordi Ekzekutiv i FAK-ut, duke përfshirë Kryetarin, Nënkryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe anëtarët tjerë të Bordit Ekzekutiv, do të përfaqësohen në mbledhjet e Kuvendit me të drejtë vote.

2.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të FAK-ut do të përfaqësohen në mbledhjen e Kuvendit PA të drejtën e votës.

2.4 Komisionet Teknike dhe Profesionale të FAK-ut përfaqësohen në Mbledhjen e Kuvendit me një (1) përfaqësues për komision PA të drejtën e votës.

2.5 Partnerët e FAK-ut dhe palët e tjera të interesit për sport dhe aeronautikë do të jenë të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit si vëzhgues vetëm nëse pjesëmarrja e tillë është e shprehur qartë në rendin e ditës së Mbledhjes së Kuvendit e cila i dërgohet të gjithë Anëtarëve Aktivë në thirrjen për Mbledhje të Kuvendit.

2.6 Anëtarët e Përkohshëm të FAK-ut do të përfaqësohen me një (1) delegat në Mbledhjen e Kuvendit si vëzhgues PA të drejtën e votës.

2.7 Anëtarët Joaktiv të FAK-ut do të përfaqësohen me një (1) delegat në Mbledhjen e Kuvendit si vëzhgues PA të drejtën e votës.



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

### **Neni 3**

#### **Kuorumi dhe vlefshmëria e kuvendit**

3.1 Kuvendi konsiderohet të ketë kuorumin minimal dhe do të jetë i vlefshëm vetëm nëse gjashtëdhjetë e gjashtë për qind (66%) e delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktiv të FAKut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj janë të pranishëm dhe të akredituar në mbledhjen e Kuvendit.

3.2 Në rast se mbledhja e Kuvendit të thirrur dhe mbledhur nuk përmbushë kuorumin minimal të kërkuar për t'u konsideruar e vlefshme, mbledhja e Kuvendit konsiderohet e pavlefshme dhe dështuar. Thirrësi i Kuvendit ka të drejtë të thërret një mbledhje tjetër të dytë të Kuvendit e cila duhet të bëhet jo më herët se 14 ditë nga tubimi i dështuar dhe jo më vonë se 28 ditë nga tubimi i dështuar i Kuvendit. Në këtë rast, kuorumi minimal që mbledhja e Kuvendit të jetë e vlefshme, vendoset në pesëdhjetë për qind (50%) të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të FAK-ut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj dhe secili janë të pranishëm dhe të akredituar në mbledhjen e Kuvendit.

3.3 Në rast se mbledhja e Kuvendit të thirrur dhe mbledhur për herë të dytë nuk përmbushë kuorumin minimal të kërkuar për t'u konsideruar e vlefshme, mbledhja e Kuvendit konsiderohet e pavlefshme dhe dështuar. Thirrësi i Kuvendit ka të drejtë të thërret një mbledhje tjetër të tretë të Kuvendit e cila duhet të bëhet jo më herët se 28 ditë nga tubimi i dështuar dhe jo më vonë se 56 ditë nga tubimi i dështuar i Kuvendit. Në këtë rast, kuorumi minimal që mbledhja e Kuvendit të jetë e vlefshme, vendoset në dyzetë për qind (40%) të delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të FAK-ut, të cilët kanë qenë Anëtarë Aktivë të FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj dhe secili janë të pranishëm dhe të akredituar në mbledhjen e Kuvendit.

### **Neni 4**

#### **Kompetencat e Kuvendit**

4.1 Në pajtim me Statutin dhe rregulloret, Kuvendi i FAK-ut do të merret me dhe do të vendosë për të gjitha çështjet legislative, ekzekutive dhe financiare të FAK-ut, përfshirë:

4.2 Përcaktimin e qëllimeve, objektivave dhe politikave të FAK-ut, si dhe krijimin e mënyrës së veprimit për të arritur qëllimet e FAK-ut.

4.3 Shqyrtimin e raporteve të Kryetarit, Bordit Ekzekutiv, Këshillit Mbikëqyrës, Kryesuesve të Komisioneve Profesionale dhe Teknike dhe individëve dhe organeve të tjera sipas rastit.

4.4 Miratimin e llogarive të FAK-ut dhe të pasqyrave financiare të përgatitura nga Auditori.



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

- 4.5 Miratimin e strategjisë së zhvillimit të FAK-ut për vitin e ardhshëm.
- 4.6 Të vendosë për klasifikimin, abonimet dhe të drejtat e votimit të Anëtarëve.
- 4.7 Largimin e anëtarëve sipas dispozitave të Statutit.
- 4.8 Marrjen e vendimeve për ankesat kundër vendimeve të Bordit Ekzekutiv ose të Komisioneve.
- 4.9 Miratimin e amendamenteve të Statutit.
- 4.10 Caktimin e detyrave tek Bordi Ekzekutiv dhe organet e tjera sipas rastit.
- 4.11 Zgjedhjen e Kryetarit, Nënkryetarit, Këshillit Mbikëqyrës dhe Bordit Ekzekutiv të FAK-ut.
- 4.12 Pranimin e Anëtarëve të rinj dhe klasifikimin e tyre fillestar, abonimin dhe të drejtat e votimit.
- 4.13 Miratimin e çmimeve, dekoratave dhe nderimeve të propozuara.
- 4.14 Vendimet për të gjitha çështjet e tjera të parashtruara dhe të dorëzuara siç duhet nga Bordi Ekzekutiv, Këshilli Mbikëqyrës dhe nga Anëtarët Aktivë të FAK-ut të paktën 14 ditë para mbledhjes së Kuvendit.
- 4.15 Miratimin e veprimeve të Bordit Ekzekutiv dhe lirimin e përgjegjësisë për këto veprime.

### **Neni 5 Votimi në Kuvend**

- 5.1 Secili Anëtar Aktiv i FAK-ut që ka qenë anëtar i FAK-ut për më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj nga anëtarësia fillestare në FAK dhe është përfaqësuar në Mbledhjen e Kuvendit nga delegatët e akredituar do të ketë nga zero (0) deri në katër (4) vota, varësisht nga klasa e anëtarësisë siç përcaktohet në nenin 2.1. të këtij dokumenti.
- 5.2 Vendimet e Kuvendit do të merren (miratohen) me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote, përveç nëse çështja është një problem/rast specifik i FAK-ut ose Anëtarëve të tij që përcaktohet nga ndonjë nen specifik statutit të FAK dhe e përcakton atë ndryshe ose kërkon dy të tretat (2/3) të votave të të gjithë delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote. Anëtarët Aktivë të FAK që mbajnë statusin e Anëtarësisë për më pak se dymbëdhjetë (12) muaj nga data e mbledhjes së Kuvendit në të cilën zhvillohet votimi nuk kanë të drejtë të votojnë.
- 5.3 Për miratimin e ndryshimit/eve të Statutit të FAK-ut, kërkohen dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë delegatëve të akredituar të Anëtarëve Aktivë të pranishëm në Kuvend me të drejtë vote.



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

5.4 Votimi bëhet me votim të hapur ose të fshehtë. Votimi i hapur mund të kryhet me ngritje të dorës; përdorim të dërrasave të votimeve ose përmes thirrjes së secilit në votim. Votimi i fshehtë bëhet me anë të fletëvotimeve me shkrim, para së cilës një komision prej jo më pak se tre (3) personave për numërimin e votave zgjidhet përmes votimit të hapur.

5.5 Kur votohet me votim të fshehtë me shkrim, secili delegatë kërkohet të vendosë në kutinë e votimit votën e tij.

5.6 Në rast të barazimit të votave (në votimin e hapur ose të fshehtë), një raund i dytë i votimit duhet të bëhet menjëherë.

5.7 Në rast të barazimit të votave për herë të dytë (në votimin e hapur ose të fshehtë), kryesuesi i Kuvendit vendos një votë shtesë për të prishur barazimin!

### **Neni 6 Organizimi i kuvendit**

6.1 Ftesa për pjesëmarrje në kuvend i dërgohet të gjithë anëtarëve aktiv të FAK, anëtarëve të përkohshëm të FAK, anëtarëve joaktiv të FAK, bordit ekzekutiv të FAK, këshillit mbikqyrës të FAK, komisioneve teknike dhe profesionale të FAK, partnerëve të FAK dhe palëve të tjera të interesit.

6.2 Ftesa për pjesëmarrje në kuvend i dërgohet të ftuarve të paktën 14 ditë para datës së mbajtjes së kuvendit.

6.3 Verifikimi i mandateve të delegatëve dhe pjesëmarrësve të tjerë bëhet gjatë regjistrimit të tyre në kuvend.

6.4 Pas verifikimit të mandateve dhe pas konstatimit që numri i pjesëmarrësve plotëson kushtet e përcaktuara për kuorum, kuvendi llogaritet i hapur, prezantohet numri votave të nevojshme për votim të thjeshtë dhe për 2/3, pastaj prezantohet rendi i ditës nga kryesuesi i kuvendit.

6.5 Rendi i ditës i propozuar duhet të aprovohet me shumicë të thjeshtë votash në kuvend, në rast të mosaprovimit me shumicë të thjeshtë në raundin e parë të votimit, kryesuesi hap diskutim për rendin e ditës, pyet delegatët për mundësitë e shtimit apo largimit të pikave të caktuara dhe pas debatit vendos përsëri në votim rendin e ditës me shumicë të thjeshtë. Në rast të mosaprovimit të rendit të ditës për herë të dytë procedura e njëjtë përsëritet edhe vetëm për një here, dhe në rast të mosaprovimit për herë të tretë atëhere kuvendi konsiderohet i pa hapur, rjedhimisht konsiderohet i dështuar. Në rast të aprovimit të rendit të ditës kuvendi automatikisht konsiderohet i hapur dhe fillon puna në kuvend.

6.6 Çdo delegat i verifikuar në kuvend ka të drejtën e fjalës dhe diskutimit për çdo pikë të rendit të ditës, dhe atë të përcaktuar sipas pikës 2.1 të kësaj rregulloreje. Nga secili delegat në kuvend kërkohet



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

sjellje e korrekte, konstruktivitet dhe disiplinë e lartë, në rast të kundërt udhëheqësi i kuvendit mund të sanksionoj delegatin ose ndërpres fjalimin.

6.7 Mbjtësi i procesverbalit obligohet që procesverbalin ashtu siq e ka, në fund të mbledhjes ta fotokopjoj dhe t'ju dërgoj pjesëmarrësve, bordi i FAK obligohet që në bazë të këtij procesverbal të krijoj dokumentin e formatizuar të procesverbalit me të gjitha të dhënat të cilët duhet ti ketë një procesverbal i rregullt dhe i kompletuar.

6.8 Procesverbal i formatizuar duhet t'ju dërgohet të gjithë anëtarëve pjesëmarrës dhe të gjithë të tjerëve të pranishëm në çfaredo cilësie që mund të jenë dhe atë jo më vonë se 14 ditë nga data e mbajtjes së kuvendit të FAK.

### **Neni 7 Udhëheqja e kuvendit**

7.1 Mbledhjet e rregullta të kuvendit të FAK udhëhiqen nga kryetari të FAK.

7.2 Mbledhjet zgjedhore të kuvendit të FAK udhëhiqen nga kryetari i kryesisë së punës. Kjo kryesi votohet me shumicë të thjeshtë nga ana e delegatëve pjesëmarrës në fillim të kuvendit dhe duhet të përbëhet nga: Kryetari, 2 (dy) anëtarë të komisionit zgjedhor për shpërndarje të fletëvotimeve dhe numrim të votave, 1 (një) mbajtës të procesverbalit dhe 1 (një) verifikues të procesverbalit.

7.3 Mbledhjet e jashtëzakonshme të kuvendit të FAK udhëhiqen nga kryetari i kryesisë së punës. Kjo kryesi votohet me shumicë të thjeshtë nga ana e delegatëve pjesëmarrës në fillim të kuvendit dhe duhet të përbëhet nga: Kryetari, mbajtësi procesverbalit dhe verifikuesi i procesverbalit. Në rast se rrjedha e kuvendit të jashtëzakonshëm kërkon që në kuvend të ketë zgjedheje të strukturave të FAK, atëhere kryesia e punës plotësohet edhe me 2 (dy) anëtarë të komisionit zgjedhor për shpërndarje të fletëvotimeve dhe numrim të votive.

7.4 Në rast të mbledhjes së rregullt të kuvendit kryetari i FAK i asistuar nga mbajtësi i procesverbalit bënë përmbledhjen e punës dhe vendimeve të kuvendit dhe i prezanton ato para kuvendit.

7.5 Në rast të mbledhjes zgjedhore ose jashtëzakonshme të FAK, përmbledhja e rezultateve të kuvendit dhe vendimet prezantohen para delegatëve nga ana e kryetarit të kryesisë së punës duke u asistuar nga mbajtësi i procesverbalit.



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

### **Neni 8 Hyrja në fuqi**

8.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i FAK.

8.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, 15.11.2018

---

Shkelqim Krasniqi

Kryesues i punës së kuvendit të FAK